

NIKOLETA CIKULI

ZHVILLIMI I DREJTSHKRIMIT TË SHQIPES PAS ÇLIRIMIT

Ndër problemet e gjuhësisë shqiptare një vend të veçantë zë problemi i drejtshkrimit. Zhvillimi dhe përmirësimi i drejtshkrimit të shqipes në periudhën pas çlirimit janë pjesë përbërëse e zhvillimit të përgjithshëm të gjuhës letrare shqipe dhe nuk mund të merren të shkëputura nga gjithë zhvillimi ekonomik, politik e kultural i vendit.

Gjatë një çerek shekulli, periudhë relativisht e shkurtër për sukseset që kemi arritur, vendi ynë ka ecur shumë përpara në çdo fushë të jetës, «Shqipëria, — ka thënë shoku Enver — nuk është më ajo e para, as ekonomia e saj, as kultura, as arësimi, as gjuha, as regjimi, as politika as ideologjia.¹

Procesi i njësimimit dhe i stabilizimit të drejtshkrimit të shqipes lidhet me procesin e kristalizimit të normës fonetike, gramatikore dhe leksikore në tërësi. Kjo lidhje e ngushtë që ekziston ndërmjet tyre më qartë dhe më tepër se kurdoherë vihet re sot, kur «gjuha jonë letrare jo vetëm pasqyron përparimin e pashembullt të popullit tonë në të gjitha fushat e veprimtarisë së tij krijuese për ndërtimin e shoqërisë socialiste, por shërben edhe si një forcë e gjallë që e ndihmon drejtpërsëdrejti ecjen përpara të kësaj shoqërie².

Përpyekjet për njësimin e shkrimit të shqipes kanë filluar që gjatë Rilindjes kombëtare, kur problemi i gjuhës ishte një nga problemet kryesore që diskutohej në shtypin e kohës, por rregullat drejtshkrimore u caktuan vetëm më 1916 nga «Komisia letrare shqipe» e mbledhur në Shkodër. Këto rregulla luajtën një rol të madh për afrimin e dy dialekteve në shkrim dhe mbetën të vetmet rregulla drejtshkrimore të shqipes deri në vitin 1948. Pas çlirimit të vendit, me çeljen e Institutit pedagogjik dyvjeçar më 1946, të Institutit të shkencave (1947), më vonë Institutit të historisë dhe të gjuhësisë (1955). Universitetit shtetëror të Tiranës (1957). u krijuan kushte të favorshme për një punë sistematike kolektive për drejtshkrimin. Fruti i kësaj pune janë: «Ortografia e gjuhës shqipe»³ më 1951, «Ortografia e gjuhës shqipe»⁴ më

1) Enver Hoxha, *Për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës sonë*, «Arësimi popullor», nr. 1, 1963, f. 23.

2) A. Kostallari, *Mbi disa veçori strukturore e funksionale të gjuhës letrare shqip të kohës sonë*. «Studime filologjike», nr. 2, 1970, f. 6.

3) *Ortografia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1951, 21 f.

4) *Ortografia e gjuhës shqipe*, «Buletin për shkencat shoqërore», nr. 4, 1956, f. 38-65.

1956 dhe së fundi «Rregullat e drejtshkrimit të shqipes»⁵ (projekt) më 1967. Secila prej tyre ka karakteristikat e veta, anët e mira dhe të metat, por që të tria ato kanë synuar për njësimin e drejtshkrimit dhe të normës gramatikore.

Në vlerësimin e tyre duhet të jemi objektivë, të marrim parasysh vështirësitë dhe kushtet kur janë hartuar ato.

Nga krahasimi i bërë midis ortografive të botuara, vihet re rritja e vazhdueshme e nivelit të tyre shkencor, përmirësimi i dukshëm qoftë në anën metodike, qoftë në atë teknike etj.

Më 1951 Instituti i shkencave, botoi broshurën «Ortografia e gjuhës shqipe» projekti i së cilës qe botuar që më 1948. «Si bazë për gjithë këtë punë, thonë hartuesit e saj në parathënie, është marrë fonetika e gjuhës, rryma e zhvillimit të saj... dhe tendenca për t'i afruar sa është e mundur më shumë të dy dialektet, toskërishten dhe gegërishten»⁶. Në mjaft raste ortografia lejon dy mënyra shkrimi, por kjo është e natyrshme dhe përligjet po të marrim parasysh se atëhere përdorëshin dy variante letrare të gjuhës shqipe. Siç dihet, çlirimi e gjeti vendin tonë pa një gjuhë të vetme letrare të formuar.

Botimi i «Ortografisë së gjuhës shqipe» nxiti dhe gjallëroi edhe më tepër diskutimet rreth problemit të ortografisë (organizimi i konsultave dhe i një konference më 1953 dëshmojnë për këtë). Kjo ortografi, siç del nga shtypi dhe nga botimet e tjera, filloi të zbatohet nga viti 1952-53, por shpejt u vu re se numri i vogël i problemeve të trajtuara nuk u përgjegjej kërkesave të kohës, kështu që më 1953 filloi puna për përpunimin e një projekti të ri, i cili në disa çështje eci më me guxim në rrugën e mënjanimi të varianteve drejtshkrimore e gramatikore, duke ngritur në normë njëren prej tyre. Komisioni i caktuar për këtë qëllim «... i vuri vetes si detyrë të plotësonte e zgjeronte ortografinë e mëparshme, të eliminonte ku ishte e mundur rastet e dualitetit të grafisë, të rishikonte normat e ortografisë së mëparshme, t'i jepte një renditje praktike»⁷.

Ngjarje me rëndësi të veçantë për gjuhësinë tonë qe botimi i «Fjalorit të gjuhës shqipe» më 1954. Si i pari fjalor shqip-shqip me synime normative, ai ndihmoi mjaft edhe për kapërcimin e një numri jo të pakë luhatqesh në shkrimin e fjalëve. Në vija të përgjithshme fjalori shqip ndoqi projektin e ortografisë të vitit 1953, pra i zbatoi ato para botimit; rregullat u botuan më 1956 nën titullin «Ortografia e gjuhës shqipe». Kjo ortografi shënoi një hap të rëndësishëm përpara për stabilizimin e gjuhës së shkruar. Në krahasim me ortografinë e 1951-së, ortografia e 1956-s dallohet për një trajtim më të gjërë dhe më të thelluar të problemeve (psh. tek zanoret, bashkëtingëlloret, emrat e përveçëm të huaj etj.); është hequr dorë në shumicën e rasteve nga lejimi i shkrimit në dy mënyra, preken probleme të reja të patrajuara në ortografinë e 1951-së (psh. emrat e përveçëm të huaj etj.).

Pas një periudhe 11-vjeçare, mjaft të gjallë e të pasur edhe për studimet gjuhësore, u botuan më 1967 *Rregullat e drejtshkrimit të shqipes* (projekt), hartuar nga një komision i Institutit të historisë dhe të gjuhësisë të përbërë nga Androkli Kostallari, Eqrem Çabej, Mahir Domi dhe Emil Lafe (asistent). Nga diskutimet e deritanishme, projekti

5) *Rregullat e drejtshkrimit të shqipes* (projekt), Tiranë 1967, f. 208.

6) *Ortografia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1951, f. 3.

7) M. Domi, *Projekti i ri i ortografisë e diskutimi i tij*, «Buletini i Institutit të shkencore shoqërore», nr. 1, 1954, f. 142.

është vlerësuar si një kontribut i madh, sepse pasqyron sukseset që kanë arritur shkencat filologjike gjatë viteve të pushtetit popullor. Si pikënisje për projektin kanë shërbyer ortografia e 1951-së dhe e 1956-s, por ai dallohet prej tyre në mjaft drejtime. Parashtrimi i lëndës thjesht sipas çështjeve drejtshkrimore e jo më sipas pjesëve të ligjëratës, zgjerimi i rrethit të këtyre çështjeve dhe trajtimi mjaft i thelluar i tyre, kufizimi i rasteve të shkrimit në dy mënyra, përpikmëria në dhënjën e përkufizimit, mbështetja për zgjidhjet që jepen në shqiptimin më të përgjithshëm, pajisja me tregues të shembujve të përdorur etj., janë karakteristika dalluese të këtij projekti. Në «Rregullat» ka edhe probleme për të cilat s'jepen zgjidhje të prera, ka nevojë aty-këtu për plotësime, sqarime dhe thjeshtime.

Gjatë njëzet e pesë vjetve që nga çlirimi i vendit, në zhvillimin dhe stabilizimin e drejtshkrimit të shqipes mund të vihen re disa faza:

Faza e parë (1945-49) karakterizohet nga një dualitet i fortë trajtash për arsye të përdorimit të dy dialekteve paralelisht, nga përzjerja e dy dialekteve në shkrim (në mënyrë të veçantë në publicistikë) dhe nga lëkundje të shumta.

Faza e dytë (1949-1956) kur bëhen përpjekjet e para për njësim dhe stabilizim; shkrimi fillon të thjeshtohet (hiqet dorë nga përdorimi i theksit hundor, i vizës pas pjesëzës *u*, i apostrofit në disa raste etj.); luhatjet vazhdojnë, por aty-këtu shfaqen edhe tendencat e zhvillimit të ardhshëm (psh. në shkrimin e fjalëve bashkë, ndarës dhe me vizë — kemi parasysh fjalët e prejardhura, të përbëra dhe të përngjitura — janë më të shumta rastet e shkrimit bashkë sesa veç ose me vizë).

Faza e tretë (1956 e këtej) kur gjuha letrare kombëtare hyn në fazën e fundit të kristalizimit. Botimi i ortografisë dhe i fjalorit shpunë në përmirësime të dukshme në njësimin e gjuhës së shkruar sidomos pas vitit 1960 (është kaluar në njësim në shkrimin e fjalëve bashkë dhe ndaras, bashkë dhe me vizë në mes, në shkrimin e fjalëve dhe të emrave të përveçëm me prejardhje të huaj, në shkrimin e ë-së fundore etj.). Por do të gabonim po të mendonim se është arritur njësimi dhe stabilizimi i dëshiruar. Botimi i projektit të 67-s dëshmon për nevojën që ka gjuha e shkruar gjatë procesit të zhvillimit të saj për përmirësimin e rregullave. Në gjendjen e sotme të gjuhës së shkruar është arritur një farë qëndrueshmërie, por prapëseprapë ka probleme të pazgjidhura. Drejtshkrim të përkver nuk mund të ketë për arsye se jo të gjitha çështjet mund të zgjidhen njëherësh, gjuha zhvillohet, nëson ndryshime që pasqyrohen edhe në shkrim. Duke ndjekur zhvillimin e drejtshkrimit të shqipes në material nga shtypi e nga të gjitha llojet e botimeve tona në 25 vjetet e çlirimit⁸ dhe duke parë edhe përmirësimet që u janë bërë rregullave drejtshkrimore nga njëri projekt te tjetri, çështjet e ndryshme që ndërthhen drejtshkrimi i gjuhës sonë mund t'i ndajmë në dy grupe: **A** Çështje që kanë qjetur zaidhje ose që janë në rrugën e zgjidhjes dhe **B** Çështje ku vihen re lëkundje të theksuara.

A Çështje që kanë qjetur zgjidhje ose që janë në rrugën e zgjidh-

8) Për këtë artikull materiali është nxjerrë nga numra të ndryshëm të revistave: *Arsimi*, *Bujku i ri*, *Punëtori i Partisë*, *Shëndetësia popullore*, *Udhëheqësi i pionierëve*, *Pararoja*, *Buletini i Institutit të shkencave*, *Literatura jonë*, *Nëndori*, *Shqiptarja e re* dhe *Ylli*; të gazetave: *Zëri i popullit*, *Bashkimi*, *Puna* dhe *Zëri i rinisë*. Po ashtu janë shfrytëzuar vepra që i përkasin letërsisë artistike, politike, tekniko-shkencore; tekste shkollore etj.

jes. — Në këtë grup përfshihen: a) ë-ja pastheksore fundore; b) shkrimi i j-së te emrat femërore që në të pashquarën mbarojnë me i të theksuar te trajtat e së tashmes dëftore e lidhore dhe e së ardhmes (v. I njëjës), te trajtat e së pakryerës dëftore, lidhore e kushtore (v. I dhe II njëjës) të foljeve të zgjedhimit të parë, te trajta e v. III njëjës e së kryerës së thjeshtë të foljeve me *oj* e *uaj*; c) shkrimi i fjalëve dhe bashkë dhe ndaras, bashkë me vizë në mes; ç) shkrimi i fjalëve dhe i emrave të përveçëm me prejardhje të huaj; d) apostrofi; dh) theksi; e) bashkëtingëlloret e zëshme në fund e në trup të fjalës.

a) *Ë-ja pastheksore fundore* — Shkrimi i ë-së është një ndër problemet më të ndërlikuara të drejtshkrimit të shqipës. Për arësye të gjëndjes së saj shumë të ndryshme nëpër dialektet, ajo paraqet luhajtje të theksuara edhe në shkrim. Për periudhën 1945-69 për ë-në e patheksuar në përgjithësi kemi vënë re: ka pasur lëkundje të shumta (dhe vazhdon të ketë) në përdorimin dhe mospërdorimin e saj në çdo pozicion (paratheksor, pastheksor jofundor, pastheksor fundor), por nga viti 1960-61 jo në masën e viteve 1945-56; gjatë viteve 1945-52 mungesa e ë-së në pozicion fundor tek fjalët me theksin në rrokjen e parafundit (p.sh. *shënj, pale*) tek emrat njërrrokësh dhe shumërrokësh që mbeten oksitonë dhe në shumësin e pashquar (*sasit, barinjt, poshtërsit* etj.), tek emrat femërorë me zanore të theksuar në rasat gjindore, dhanore dhe rrjedhore të trajtës së shquar (*dashuris, kalas* etj.) tek emrat femërorë me zanore të theksuar në rasën kallëzore të trajtës së shquar (*pabarazin, fuqin, tradhtin*), tek mbiemrat e prejardhur, nga numërorë e ndajfolje me anë të prapashtesës të (*izjarrt, i shenjtë*) tek foljet me temë në zanore të mënyrës dëftore dhe lidhore koha e tashme v.III njëjës dhe shumës, veta I shumës (*shkruajn, festojm ...* etj.) etj. dhe përdorimi i saj pa vend po në këtë pozicion (P.sh. *shtëpishë, parasyshë, e mbuluarë, janë vërtetuarë, i ndanë, lartë, pakë, shpeshë* etj.) haset shumë më shpesh se sa pas vitit 1952-53; tendencën e reduktimit të ë-së te fjalët e përngjitura në mbiemrat e prejardhur me prapashtesën -shëm (si pasojë e reduktimit të saj në shqiptim) dhe më pak në fjalët e përbëra. Si përfundim, mund të themi se në përdorimin e ë-së fundore është ecur më lehtë dhe më shpejt drejt stabilizimit, ndërsa në pozicionet e tjera kjo zanore nuk ka mundur të gjejë një zgjidhje të kënaqshme as në teorinë e drejtshkrimit, as në praktikën e shtypit.

b) *Shkrimi i j-së te emrat femërorë që mbarojnë me i të theksuar, te trajtat e së pakryerës dëftore, lidhore e kushtore (v. I dhe II njëjës) të foljeve të zgjedhimit I, te trajta e v. III njëjës e së kryerës së thjeshtë të foljeve me -oj e -uaj.*

Një nga treguesit që paraqet qartë procesin e stabilizimit të drejtshkrimit është shkrimi i bashkëtingëllores -j. Lëkundjet në përdorimin dhe mospërdorimin e kësaj bashkëtingëlloreje në fjalë të të njëjtit tip kanë vazhduar për një kohë të gjatë sikurse edhe për zanoren ë, por me ndryshim se ndërsa në përdorimin e ë-së ka akoma mjaft luhajtje e çështje të pazgjidhura, në përdorimin e j-së kalimi drejt stabilizimit dhe njësimi vihet re më qartë. Për këtë mjafton të shohim si paraqitet gjendja tek emrat femërorë që mbarojnë me i të theksuar (p.sh. *Shqipëri, shtëpi* etj.). Për kalimin në shkrimin e këtyre emrave nga trajta me -ija te -ia u desh një kohë e gjatë (nga 1945-1949 gjejmë paralelisht të dy trajtat: *Shqipërija, drejtorija, ushtria* dhe *Partia, pavarësia, Persia* etj.), por me epërsi të trajtës me -ija; nga 1951-60-61, pas botimit të ortografisë të 1948-s, përdoret më dendur trajta me ia,

sidomos në tekstet shkollore; nga 1961-69 sundon trajta me *-ia*, rrallohet shumë trajta me *-ija*. Duke krahasuar rastet e përdorimit dhe të mospërdorimit të *j-së* në trajtën e emërores së shquar me të gjindore-dhanore-rrjedhores së pashquar kemi vënë re se kalimi nga *-ija* në *-ia* është bërë më me lehtësi se sa kalimi nga *-ije* në *-ie* (p.sh. nga njëra anë *Partia, Shqipëria, ushtria*, nga ana tjetër *mërzije, cilësije, kredije* etj.)

Për luhatjet *nj-j* në sistemin foljor vihet re se është kaluar nga trajta me *-nj* në trajtën me *-j* (për foljet e përmendura në pikën b), d.m.th. të së pakryerës së dëftores, lidhores dhe kushtores); të dy trajtat janë përdorur në të njëjtën kohë nga 45-69, por me këto ndryshime: nga 1945-56 ka mbizotëruar trajta me *-nj* (p.sh. *besonja, linja, arsye-tonja, të gjenja, të ecnja* etj.), pas 1956-s dhe sidomos pas 1961-së fillon të përdoret gjithmonë më dendur trajta me *j* (p.sh. *shqiptoja, përballoja, doja* etj.); pas 1965-s autorë të jugut kalojnë në masë drejt trajtës me *-j*. Si rezultat i ngritjes së nivelit të përgjithshëm arësimor të masave, konstatojmë se nga viti në vit bëhen më të rralla rastet e ngatërimit në shkrim të vetës III të së kryerës së thjeshtë numër njëjës me veten I të së tashmës numër njëjës (p.sh. gjer më 1953 krahas trajtës me *i -krijoi, shkoi, harroi, lundroi* gjejmë dhe trajtën me *j*: p.sh. *filloj* (kurimi), *fitoj* (teoria), *sulmoj* (brigada) etj.

c) *Shkrimi i fjalëve bashkë dhe ndaras, bashkë dhe me vizë në mes*. Kalimi drejt trajtave të njësuara shihet qartë në shkrimin e fjalëve bashkë dhe ndaras, bashkë dhe me vizë në mes. Lidhur me këtë problem kemi vënë re një pasiguri të theksuar dhe mungesë kriteri për një kohë të gjatë (1945-61-62). Këto kanë shpënë në shkrimin e së njëjtës fjalë në 2-3 mënyra (p.sh. : *veç se, veçse, menjë herë, me njëherë, menjëherë* etj.). Në shkrimin e përemrave të pakufishëm, ndajfoljeve, lidhëzave dhe parafjalëve të tipit *asnjeri, gjithmonë, simbas, përballë* pas 1958-1959 — bie në sy prirja për t'i shkruar bashkë ndërsa për lokucionet e tipeve *veç e veç, mes për mes* u bë i përgjithshëm shkrimi ndaras.

Në krahasim me gjendjen e sotme, viza ka pasur përdorim më të gjerë (përdorej edhe te fjalët e prejardhura dhe te të përbërat); me kalimin e kohës është ecur drejt kufizimit të përdorimit të saj, gjë që ka ndihmuar për thjeshtimin e shkrimit. Shkrimi i fjalëve bashkë dhe me vizë, bashkë dhe ndaras, sipas kërkesave të ortografisë të 51-së e të 56-s është zbatuar më përpara në publicistikë dhe në tekstet shkollore, ndërsa në letërsinë artistike më vonë. Luhatjet që kanë ekzistuar në shkrimin e fjalëve bashkë dhe ndaras bashkë dhe me vizë në mes, e vemë re te: a) *parafjalët, ndajfoljet, lidhëzat e përbëra dhe përemrat e pakufishëm* që i gjejmë të shkruar në dy-tri dhe rrallë në katër mënyra: *as-gjë, asgjë, ndo-një, ndonjë, si-pas, sipas, sa po, sapo, me-zi, me zi, mezi, më një anë, më njëanë, mënjëanë; dal nga dalë, dalë ngadalë, dal-nga-dalë dalngadalë* etj.); b) *lokucionet lidhëzore, parafjalore dhe ndajfoljore* që janë shkruar: 1) herë veç, herë bashkë (p.sh. *an'e mb'anë, an e mbanë, anembanë; në qoftë se, në qoftëse, nëqoftëse; tej për tej, tej përtej, tejpërtej*; 2) herë veç, herë me vizë (p.sh. *sot-për-sot, sot për sot; rreth-e-rrreth, rreth e rreth, krah-për-krah, krah për krah*; 3) veç me vizë ose bashkë (p.sh. *mes për mes, mes-për-mes, mespërmes; aty për aty, aty-për-aty, atypëraty* etj.); c) *disa tipe fjalësh të prejardhura* që i hasim të shkruara: 1) në dy mënyra (me vizë ose bashkë) p.sh. *nën-kryeministër, nëndrejtor*, (veç dhe bashkë) p.sh. të *porsa lëruara, e porsaçlëruara*; 2) në tri mënyra: para-

shtesa veçohet nga trupi i fjalës, ndahet me vizë ose shkruhet bashkë p.sh. të *pa fajshëm*, të *pa-para*, të *paperërë*; *anti fashist*, *anti-marksiste*, *anti-historike*, e *gjer tanishme*, e *gjer-tanishme*, e *gjertanishme*, e *më-parshme*, e *më vonshme*, e *mëpastajme* etj. ç) *fjalët e përbëra*: për një periudhë, që mund ta quajmë periudhë kalimtare, te fjalët e përbëra viza ka pasur përdorim të gjerë. Këto fjalë, ndryshe nga të prejardhurat, i gjejmë me dendur të shkruara me vizë dhe bashkë, dhe më rrallë të shkruara veç. Pas 1956-ës përgjithësohet shkrimi bashkë i fjalëve të përbëra, por s'përfashtohen rastet e përdorimit të vizës nga autorë të veçantë për arësyje të traditës.

Fjalët e prejardhura me parashtesat: *anti-*, *gjer-*, *më-*, *mos*, *pa-*, *nën-*, *kundër-*, *para-*, *pas-*, *vet-*, *tej-*, *porsa-*, *sipër-*, *poshtë-* dhe me fjalët: *bashkë-*, *shumë-*, *mirë-*, *gjysmë-*, *një-*, *ashtu-*, që dikur (1945-61), janë shkruar sipas mënyrave të përshkuara më lart, sot, veç ndonjë përjashtimi të rrallë, i gjejmë të shkruara vetëm në një trajtë, si një fjalë të vetme, pra është arritur njësimi njëkohësisht dhe stabilizimi i shkrimit të tyre.

ç) *Shkrimi i fjalëve dhe i emrave të përveçëm me prejardhje të huaj*.

Megjithëse edhe sot vihen re luhatje në shkrimin e fjalëve me prejardhje të huaj, shumë kategori prej tyre, në krahasim me të kaluarën, kanë gjetur një farë zgjidhjeje ose janë në rrugën e zgjidhjes. Duke ndjekur procesin e zhvillimit të gjuhës së shkruar, mund të vihet re se është kapërcyer faza e gjendjes kaotike që ekzistonte në shkrimin e këtyre fjalëve⁹. Shkrimi i fjalëve dhe i emrave me prejardhje të huaj është një nga çështjet e ndërlikuara të drejtshkrimit jo vetëm për gjuhën shqipe, por edhe për gjuhë të tjera. Fjalët që hyjnë në një gjuhë, qofshin këto dhe me karakter ndërkombëtar, nuk shkruhen gjithmonë njëjloj, pësojnë dhe ato ndryshime. Shkaku i shkrimit të ndryshëm për disa raste duhet kërkuar në faktin se herë është marrë për bazë mënyra e shqiptimit të një gjuhe, herë të një tjetre (p.sh. fjalët që në greqishten e vjetër fillojnë me zanore të aspiruar dhe në latinishte me *h*, në gjuhën tonë janë shkruar për periudhën 45-56-69 herë me *h*, herë pa *h*; p.sh. *hidraulike*, *harmoni*, *hermetikisht*, *horizont*, *homonime*; *idraulike*, *armoni*, *ermetikisht*, *orizont*, *omonime* etj.); fjalët e tipit *definitiv*, *decisiv*, *pasiv* etj. herë me *-v* herë me *-f* në fund, d.m.th. herë sipas shqiptimit të italishtes, (me *v*) herë sipas shqiptimit të frëngjishtes (me *f*).

Për shkrimin e fjalëve të huaja kemi vënë re këto:

1) Fjalët e huaja që kanë *-io-*, *-ia-*, *-ie-*, me *i* të patheksuar në trup të fjalës kanë kaluar nëpër këtë rrugë: nga 1945-49 shkruheshin më shpesh me *i* (*revolucion*, *imperializëm*, *ambicie*) dhe më rrallë me *j* (*revolucion*, *imperjalizëm*, *ambicje*); nga viti 49-56 shtohet përdorimi i *j-së*, ndërsa pas 1957-s fillon përsëri përdorimi i *i-së* në shkallë të gjërë.

2) Te fjalët ndërkombëtare me burim nga greqishtja e vjetër që përmbajnë *dh*, *th*, *ll* është kaluar nga trajta me *dh*, *th*, *ll* në atë me

⁹ Një rol mjaft të rëndësishëm për shkrimin sa më unik të fjalëve të huaja kanë luajtur ortografitë e 51-së, në mënyrë të veçantë ajo e 1956-s e cila këtë problem i kushton kapitull më vete (shih «Buletin për shkencat shoqërore», nr. 4, 1956, f. 44-46.

d, t, l (p.sh. *orthodhoks - orthodox, matematikë - matematikë, fillozof - filozof* etj.).

Nga 1945-51 këto fjalë hasen rrallë të shkruara me *d, t, l*, nga 1951 deri më 1959 ekzistojnë paralelisht të dyja trajtat, por duke fituar epërsinë trajta me *d, t, l*; pas 1960 trajtat me *dh, th, ll* shfaqen gjithmonë më rrallë (më gjatë *ll*-ja ka rezistuar tek fjalët *ideologji* dhe *logjikë*).

3) Fjalët me burim nga greqishtja, latinishtja e nga gjuhët romane, që në ato gjuhë kanë një *g* të ndjekur nga *e* dhe *i*, në gjuhën shqipe janë shkruar përgjithësisht me *gj*, por për vitet 1945-47-53 nuk përjashtohen rastet e shkrimit me *ge, gi* (p.sh. *borgezisë, digestiv, hemoragi* etj.).

4) Fjalët me burim nga greqishtja e vjetër që kanë në atë gjuhë *y* janë shkruar përgjithësisht me *i*, por aty-këtu gjer më 1950 edhe me *y* (sidomos nëpër revista shkencore p.sh. *rythmik, hypersensibilitet, linotype, hygienike, sytmatologji, typike, gjymnastikë* etj.).

5) Ndër fjalët e huaja të shkruara vazhdimisht njëloj bëjnë pjesë ato me zanore *o* të dyfishuar (p.sh. *zotekni, alkool, kooperativë* etj.).

Në shkrimin e fjalëve të huaja emrat e përveçëm përbëjnë një problem më vete, sepse herë janë shkruar sipas grafisë së gjuhës përkatëse (me përjashtim të emrave sllavë) pavarësisht nga shqiptimi. herë sipas shoqimit që kanë në atë gjuhë dhe herë në mënyrë të përzjerë. Në gjendjen e sotme ky problem është pothuajse i zgjidhur për arësyse se ndiqet një rrugë e vetme: shkruhen përgjithësisht sipas shqiptimit të tyre në gjuhët përkatëse. por me grafinë e gjuhës sonë.

d) *Apostrofi* — Përdorimi i apostrofit ka ardhur duke u kufizuar. Si përfundim, është kaluar drejt thjeshtimit e lehtësimit të shkrimit dhe drejt ruajtjes së plotë të trajtave të fjalëve¹⁰. Gjatë periudhës 1945-50 apostrofi është përdorur gjerësisht (p.sh. *hekurudh' e rinisë, bujë trumpeta, m'e fortë, gjith'ashtu, ç'farë, ç'mos, n'oborr, s'afërm, t'a, me'to, ç'do* (gjë), *t'im, s'onë, t'anë* etj.), nga 50-59 shfaqen lëkundiet (tek të njëjtat fjalë përdoret dhe s'përdoret) ndërsa nga 60-63 vihet re kufizim dhe stabilizim në përdorimin e tij.

Apostrofi ka qenë përdorur: në rastet e elidimit të *ë*-së fundore të patheksuar, kur pas saj vjen një zanore (p.sh. *Shqipërim'e Veriut, nambuku' e bardhë* etj.) më dendur dhe më rrallë kur pas saj vjen një bashkëtingëllore (*çfar' lavdi, dy or'ma* par etj.). Është për t'u vënë në dukje se ky fenomen është shfaqur pas vitit 1947. Ka qenë përdorur gjithashtu te fjalët e përngjitura (*nja, gjith'ashtu, m'at'anë, më nja'anë* etj.), te përemri pyetës *çfarë*, (në raste të rralla e gjejmë gjer më 1960), te nyjat *të, së* dhe te parafjala *në* kur pas tyre vjen një fjalë që fillon me zanore (p.sh. *t'armikut, s'afërm, n'ato*) gjer më 57-59. Pas 1960 apostrofi kufizohet te fjalët *s'ëmës, t'et, t'ardhurat* etj. Përsa i përket përdorimit të apostrofit në trajtat e shkurtëra të përemrave vektorë, te pjesëza *të* e mënyrës lidhore para trajtave të shkurtëra të përemrave vektorë. më tepër se kudo bie në sy ndryshimi në shkrimin e trajtës së kontraktuar *ta*, e cila më 1945-48 është shkruar pothuajse vetëm me apostrof, më 49-52 me dhe pa apostrof. (*t'a dhe ta*) në niërën anë ruhet tradita, në anën tjetër vihet në zbatim ortografia e 51-së. Në vitet

10) Nga një krahasim midis ortografive, përta i përket apostrofit, shihet se projekti i 48-s, duke u nisur nga gjendja reale e gjuhës së folur dhe të shkruar, rekomandon njëkohësisht trajta me dhe pa apostrof. e 51-së kufizon përdorimin e tij, ndërsa e 1956-s veç kufizimit, mëshon në rastet kur duhet përdorur pa tjetër.

1952-57 trajtat pa apostrof bëhen mbizotëruese. Për një kohë të gjatë (45-57) apostrofi është përdorur te përemrat pronorë p.sh. (*t'im, s'ime, t'ënd, t'onë, s'onë, t'anë*), te përemrat dëftorë të v. III njëjës dhe shumës në rasën kallëzore kur vijnë pas një parafjale dhe nuk kanë parathesën *a-* (gjer më 1952) p.sh. *në'të, në'ta, përmbi'të, me'to, nëpër'të, për'ta* etj.

Në përgjithësi në shkrim është bërë dallimi midis mbiemrit të pakufishëm *çdo* dhe përemrit pyetës ç pranë foljes *do*, por; ndërsa sot këto nuk ngatërrohen, nga viti 1946-55 gjejmë disa raste të përdorimit të gabuar të apostrofit te mbiemri i pakufishëm *çdo* p.sh. *ç'do* (ferrë), *ç'do* (ekonomi), *ç'do* (vit) etj.

dh) *Theksi*. — Për drejtshkrimin e shqipes theksi nuk ka qenë dhe nuk është problem. Në krahasim me gjuhët e tjera gjuha jonë është më e thjeshtë në shkrim edhe për arsye të mospërdorimit të tij. Nga lënda e vëzhguar është vënë re se vitet e para, 1945-47, u përdor theksi hundor në botimet e dialektit gegë (p.sh. *âsht, domethânjen, kâmbëngulje* etj.), ndërsa më vonë u hoq dorë prej tij. Theksi i zakonshëm është përdorur (jo prej të gjithë autorëve dhe organeve) në disa raste: 1) në fjalët *homonime* për të bërë dallimin kuptimor të tyre p.sh. (vë) *ré* nga *re* (reja); *majá* (tharm) nga *maja* (pika më e thepisur e një trupi); *dhé* (dheu) nga *dhe* (lidhëzë), tek kjo fjalë është përdorur deri von. *idé* (mendim) nga *idé* ose *hide* (bimë nga familja e ramana-ceve), *lirí* (liria) nga *liri* (bimë) etj.etj. 2) në fjalë një ose dyrokëshe oksitone si i *rí, fé, né, kalá, rrëké*, për të shënuar gjatësinë e zanores; 3) në fjalë të përngjitura dhe të përbëra për të përcaktuar se cila pjesë e fjalës ruan theksin (p.sh. *kudó, përdhé, nësé*), 4) në emra vendesh që mund të shqiptohen gabim (p.sh. *Mushqetá, Babrú* etj.); 5) në fjalë të huaja (emra të përgjithshëm dhe të përvencëm vendesh dhe njerëzish) për të mënjeluar shqiptimin e gabuar (p.sh., *Krimé, Mauzolé, traké, vegjetó* epopé etj.) Sot, me përjashtime shumë të rralla (si tek fjalët *dhé, né*) në gjuhën tonë të shkruar nuk përdoret asnjë lloj theksi.

e) *Bashkëtingëlloret e zëshme në fund e në trup të fjalës*.

Po të bëhet krahasimi midis shkrimeve të periudhave të ndryshme, ndryshimi më qartë se kudo do vihet re në shkrimin e bashkëtingëlloreve të zëshme në fund dhe në trup të fjalës. Fenomeni i shurdhimit të bashkëtingëlloreve të zëshme kur gjenden në fund ose në mes të fjalës para një bashkëtingëllojeje të shurdhët, karakteristik në të folmet e Shqipërisë së Jugut dhe të Mesme, është shfaqur edhe në të shkruar. Kalimi nga bashkëtingëlloret e shurdhëta në të zëshme nuk është bërë menjëherë, por duke kaluar nëpër disa faza: faza I nga 1945-52, ka epërsinë trajta me bashkëtingëllore të shurdhëta, p.sh.: *i math, funt, vent, garth, breth, përmblihdte, elp, zog, mëngjes*, por edhe *mëngjiez, larg, shkrumb* etj., faza II 1952-63 shtohen rastet e përdorimit të bashkëtingëlloreve të zëshme, faza III 1963-69 fiton epërsinë trajta me bashkëtingëllore të zëshme. Nga të gjitha bashkëtingëlloret e shurdhëta rezistuan për një kohë më të gjatë *t-ja* dhe *th-ja* (*funt, i math* etj.); më konservatorë për ruajtjen e bashkëtingëlloreve të shurdhëta janë treguar shkrimtarët. Sot shkrimi i këtyre bashkëtingëlloreve, pavarësisht nga shqiptimi, nuk përbën problem.

B. *Cështje ku vihen re lëkundje të theksuara*.

Në këtë grup përfshihen: a) zanorja *e* e theksuar në fjalët ku ndiqet nga një bashkëtingëllore hundore; b) *ë-ja* paratheksore dhe pas-theksore (jofundore); c) trajta e shquar e rasës emërore e emrave që mbarojnë me *o* të patheksuar; ç) trajta e shkurtër e përemrit vetor të vetës

së tretë njejës *i*, kur bashkohet me një trajtë të shkurtër përemërore të përfaqësuar nga një zanore ose me pjesëzën *u* të formës pësore; d) takime bashkëtingëlloresh; dh) sh-/ç nistore; e) emrat e përvjetorëve kur numërori shënohet me shifër, fjalët e prejardhura me parashtesën *jo-*.

a) *Zanorja e theksuar në fjalët ku ndiqet nga një bashkëtingëllore hundore.*

Një numër fjalësh me *e* të theksuar në trup të tyre të ndjekur nga një bashkëtingëllore hundore, për arësye të shqiptimit të ndryshëm nëpër krahina të ndryshme, janë shkruar dhe vazhdojnë të shkruhen herë me *e* e herë me *ë*, në një masë të tillë që nuk jep mundësi të nxirret përfundimi se cila trajtë ka epërsinë. Si në vitet e para pas çlirimit ashtu edhe sot, fjalët *brenda, gjendja, kuvend, i dendur* etj. i gjejmë edhe me *e* edhe me *ë*. Rregullat e drejtshkrimit të shqipes (1967), duke u nisur nga shqiptimi më i përgjithshëm japin si të drejtë trajtën me *e*, por duhet vënë në dukje se në shtyp nuk është vënë re kjo gjë.

b) *Ë-ja paratheksore dhe pastheksore (jofundore).* — *Ë-ja* në pozicionin paratheksor dhe pastheksor jofundor nuk ka mundur të gjejë zgjidhje. Ka pasur dhe ka lëkundje të theksuara dhe të vazhdueshme gjatë gjithë periudhës (1945-69) aq sa është vështirë të dallohet tendenca mbizotëruese. Është vënë re se pas 1958-s rastet e rënjes së *ë-së* në këto pozicione kanë ardhur duke u shtuar. Në krahasim me fjalët e parme dhe të prejardhura, *ë-ja* paratheksore është ruajtur më tepër në fund të temës së parë të një fjale të përbërë tema e dytë e së cilës fillon me bashkëtingëllore, (p.sh. *kokëfortë, bashkëjetesë, frymëmarrje*), ndërsa ka rënë më parë të fjalët e përbëra dhe të përngjitura, tema e dytë e të cilave fillon me zanore (p.sh. *bashkatdhetar, pël-hurendës, bashkekzistencës*) dhe të fjalët e përngjitura dhe të prejardhura që kanë si pjesë përbërëse përemrin *gjithë* (p.sh. *gjithnjë, me-gjithse, gjithmonë* etj.).

c) *Trajta e shquar e rasës emërore e emrave që mbarojnë me o të patheksuar.*

Problemi i shkrimit të emrave që në emëroren njëjës në trajtën e pashquar mbarojnë me *o* të patheksuar mbetet i pazgjidhur. Nga materiali i vëzhguar dhe sipas të dhënave të kartotekës së kulturës së gjuhës, del se në formimin e emërores së shquar të këtyre emrave vazhdimisht ka pasur luhajtje (janë shkruar dhe shkruhen në të njëjtën kohë me *-ua*, psh. *Nikua* dhe *-oja, Nikoja*). Por vihet re një epërsi e trajtës me *-ua* (nga shembujt e nxjerrë prej materialit të lexuar del një raport 3 me 1 në të mirë të *-ua-së*). Trajtën me *-oja* e takojmë kryesisht në emra të përgjithshëm dhe të përveçëm me prejardhje të huaj (p.sh.; *radjoja, kostoja, tornoja, Kastroja* etj.); disa emra të këtij lloji i gjejmë të përdorur edhe në trajtë të pashquar (duhet patjetër trajta e shquar) kur brenda fjalisë luajnë rolin e kryefjalës.¹¹⁾

c) *Trajta e shkurtër e përemrit vetor të v. III njëjës i kur takohet me një trajtë të shkurtër përemërore të përfaqësuar nga një zanore ose me pjesëzën u të formës vetvetore — pësore.* Trajta e shkurt-

11) Kjo s'ka të bëjë me drejtshkrimin, por e përmendim se në këto raste shfaqet qartë vështirësia që has ai që shkruan në zgjedhjen e njëres ose tjetres trajtë p.sh. shkruhet: «Filloi Violeta e para. Pastaj Flutura, Jorgo e kështu me radhë». (Adriatiku, nr. 21, d. 23, f. 3) në vend të: *Jorqua* ose *Jorgoja*.

tër *i* e bashkuar me një tjetër trajtë të shkurtër të përfaqësuar nga një zanore ose me pjesëzën *u* të formës pësore për periudhën 1945-69 është shkruar në dy mënyra: *i a, ia i u, iu* dhe *ja, ju* (por *ju* shumë rrallë). Gjatë gjithë periudhës përdorim më të gjerë kanë pasur trajtat *i a, ia*, dhe *i, u, iu*. Të shkruara veç (*i a, i u*) i gjejmë për një periudhë të caktuar (1945-52), por ka gjurmë gjer më 59-60. Pas 1958-60-s haset më dendur trajta *ja*, megjithatë epërsinë e ka pasur dhe e ka trajta *ia*.

d) *Takime bashkëtingëlloresh*. — Gjendja nuk është stabilizuar ende në fjalët ku takohen shkronja të tilla që mund të lexohen si një tingull i vetëm, po ashtu edhe te fjalët ku takohen dy *t* ose një *t* me një *d*. Fjalët, p.sh. kur takohen shkronjat *g* ose *n* me *j*-në janë shkruar dhe vazhdojnë të shkruhen: duke shtuar një *ë* midis *n-së* dhe *j-së*, *g-së* dhe *j-së* p.sh. *parathënëja, djegëjeve, domethënëja* etj.; duke shtuar një *i* midis tyre (rrallë) p.sh. *qënija*, duke shkruar *i* në vend të bashkëtingëlloreve *j* p.sh. *rënia, vënia, djegia, shmangien* etj.; ose thjesht me *gj, nj* (lexo *g-j n-j*). Me saktësi nuk mund të përcaktojmë se cila trajtë ka pasur epërsinë në këtë apo atë periudhë, por në përgjithësi është vërejtur se nga viti 1945-50 përdorej më tepër *ë-ja* midis shkronjave *g-n* dhe *j*, nga 52-59 janë më të shpeshta rastet e shkrimit të tyre pa ndërmjetësinë e ndonjë zanoreje tjetër (*ë* ose *i*), ndërsa pas 1959-s fiton epërsi trajta *-ni, -gi* (p.sh. *shmangie, djegie, lagie, Niazi, marrëdhënie* etj.).

Te fjalët, sidomos te emrat e përveçëm, kur takohen *d, t* me *h*-në, për të mos u lexuar *dh, th*, është përdorur dhe vazhdon të përdoret më dendur apostrofi, më rrallë viza dhe *ë-ja* (p.sh. *Bet'hoven, Et'hem, Mit'hat, Mat'hauzen, Bet'hoven, Et'hem*). Foljet që në të tashmen e dëftores vetë I numër njëjës mbarojnë me *d*, në vetën III të së pakryerës, numër njëjës janë shkruar herë me *ë* dhe herë pa *ë* (p.sh. *bindëte* dhe *bindte, lindëte* dhe *lindte*). Kjo ndodh edhe me foljet që në të tashmen e dëftores veta I mbarojnë me *t*, në vetën III të së pakryerës (*zgjatëte, nxitëte, hashtëte*) veçse vemë re që *ë-ja* më dendur është përdorur në takimin e *d-së* me *t-në* (*mundëte, tundëte, lindëte*) se sa të dy *t-ve*. Sot, në shkrimin e foljeve të lartpërmendura ka epërsi trajta pa *ë*, por e vemë në dukje përdorimin e *ë-së* për këto raste, sepse vihet re një farë shtimi i përdorimit të saj në këtë pozicion në literaturën tekniko-shkencore.

dh) *sh* - /çnistore. Gjer më 1960 qoftë përpara një bashkëtingëlloreje të pazëshme (*f, h, p, q, t, th*), qoftë përpara bashkëtingëlloreve të zëshme (*b, d, g, gj, v*) është përdorur përgjithësisht *ç-ja* p.sh. *çfrytëzim, çkathësi, u çpall, u çduk, çvillim* etj. *sh-ja* del në raste sporadike, ndërsa pas 1960-s sidomos pas 1962-s gjendja ndryshon, kalohet nga *ç* në *sh* dhe *zh* (*shfrytëzim, shkatërrim; shpifje, zhdukje, zhvillim* etj.). Më përpara *sh-ja* dhe *zh-ja* nistore filloi të përdoret në shtyp, ndërsa në letërsinë artistike më vonë. Kjo *ç-* parashtesë ose *jo*, po reziston më tepër para bashkëtingëllores së pazëshme *p*, ndërsa më pak para bashkëtingëllores së zëshme *d*.

e) *Emrat e përvjetorëve kur numërori shënohet me shifër, fjalët e prejardhura me prapashtesën jo-*.

Në përdorimin e vizës nuk janë të rralla rastet e lëkundjeve, por nga materiali i vëzhguar bie në sy se viza është përdorur dhe përdoret më me vështirësi se kudo në emërtimet e përvjetorëve dhe të tipeve

analoge ku numërori shënohet me shifër. Pas 1960-s dëndësohen rastet e përdorimit të saj për këtë rast, por ende vihet re pasiguri (p.sh. edhe sot gjejmë krahas trajtave të drejta: *25-vjetorit, 44-vjetorit, 14-vjeçar* dhe trajtat e gabuara *25 vjeçare, 5 vjeçar, 100 vjetori* etj.).

Ndërsa te shkrimi i fjalëve të prejardhura me parashtesat *anti-, gjer-, më-, mos-, tej-, porsa-* etj. (pa marrë parasysh ndonjë rast të rrallë të shkrimit veç) është arritur njësimi (parashtesa është pjesë e pandarë e fjalës) (p.sh. *i gjertanishëm, i mëvonshëm, mospërdorimi, tejkalimi, e porsaçelur*) në ato me parashtesën *jo-* vazhdojnë luhatjet; *jo-* në shumicën e rasteve shkruhet e veçuar p.sh. *jo reale, jo normale, jo zyrtare* në vend të *joreale, jonormale, jozyrtare* etj.

Për mendimin tonë, arësyeja duhet parë te ruajtja e një kuptimi dhe theksimi të mëvetësishëm të parashtesës *jo* në krahasim me parashtesat e tjera.

Nga ky vështrim i shpejtë dhe mjaft i përgjithshëm rreth drejtshkrimit të shqipes pas çlirimit, në këtë periudhë të një zhvillimi ekonomik e kultural të paparë në vendin tonë, mund të nxirren disa përfundime:

Së pari: Për arësye të kristalizimit të gjuhës letrare kombëtare përrherë e më tepër *hiqet dorë nga trajtat dialektore dhe nga lejimi i dy mënyrave të ndryshme në shkrim.*

Së dyti: është stabilizuar përfundimisht drejtshkrimi për disa raste të veçanta, ku më parë viheshin re lekundje të theksuara (këtë gjë e vëmë re te zanorja ë fundore, bashkëtingëllorja j, bashkëtingëlloret e zëshme në fund e në trup të fjalës, te shkrimi i fjalëve bashkë dhe ndaras, në disa raste të përdorimit të shkronjës së madhe etj.).

Së treti: Për shumë çështje të pazgjidhura po bëhet gjithmonë më e qartë rruga e zgjidhjes së tyre.

Së katërti: është arritur edhe thjeshtësimi i shkrimit (kemi parasysh mospërdorimin e theksit, kufizim në përdorimin e apostrofit dhe vizës lidhëse, shkrimin e emrave të përveçëm të huaj me grafinë e gjuhës sonë etj.).

Ngritja në përgjithësi e nivelit kultural të masave, zbatimi në shtyp i rregullave të drejtshkrimit, lidhja gjithmonë më tepër e teorisë me praktikën në mësimin e gjuhës, interesimi më i madh i institucioneve të ndryshme botuese për anën gjuhësore të veprave, kualifikimi i punonjësve të shtypit, propaganda gjuhësore më e gjerë, do të shpejtojë procesin e stabilizimit të normës drejtshkrimore në gjuhën tonë.

*Résumé***LE DEVELOPPEMENT DE L'ORTHOGRAPHI ALBANAISE
APRES LA LIBERATION**

Dans l'article, la Cikuli brosse un aperçu général sur le développement de l'orthographe albanaise après la libération.

Après avoir fait un examen critique aux orthographes faites éditer (*Orthographe de l'albanais* 1951, *Orthographe de la langue albaanise* 1956 et *Règles de l'orthographe albanaise*) et après avoir passé en revue les conditions de leur stabilisation, l'auteur considère trois phases dans le développement et la stabilisation de l'orthographe: la première phase (1945-1949) est caractérisée par une forte dualité de formes; la deuxième phase (1949-1956) est celle des premières tentatives pour l'unité et la stabilisation; la troisième phase (1966 et ensuite) est celle de l'entrée de la langue nationale à sa dernière phase de stabilisation.

Dans l'exposé ci-contre en albanais, les questions de l'orthographe sont divisées en deux groupes: A. Questions qui ont trouvé leur solution ou bien qui sont sur la voie de leur solution; B. Questions qui donnent lieu à des écarts.

A la fin de son exposé, l'auteur tire quelques conclusions.